

07.02.2022

Ora 18:13

## **RENDI I DITËS**

Projektvendimi "Për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022".

### **PJESËMARRJA :**

#### **KQZ:**

- **Komisioni Rregullator:**


- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Y.Merkaj, M.Koja, E.Meta, B.Kodra

Parti Politike: S'ka

OJQ KRIK

*Znj. I. Nano:* Mirëmbërëma! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të thirrur për ditën e sotme, e hënë, datë 07 shkurt 2022. Mbledhja e Komisionit Rregullator është njoftuar rregullisht në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Gjithashtu u është njoftuar partive politike, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në mbledhje janë të pranishëm anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës së KQZ-së. Në rendin e ditës të mbledhjes kemi shqyrtimin e projektvendimit "Për

Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.07.02.2022*

miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që zhvillohen më datë 6 Mars 2022”. Ky projektvendim ka ardhur për shqyrtim në Komisionin Rregullator me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Para se të fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit, do t’u lutesha kolegëve, nëse kanë ndonjë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar! Kolegë? Nuk ka! Atëherë fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit. Do t’i lutesha Sekretarit të Përgjithshëm të prezantonte projektaktin.

**Z. Y. Merkaj:** Projektaktin do ta prezantojë Shefi i Koordinimit dhe Mbikëqyrjes, zoti Blendi Kodra.

**Znj. I. Nano:** Zoti Kodra!

**Z. B. Kodra:** Ju kemi paraqitur për miratim projektvendimin “Për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar, në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që do të zhvillohen në datën 6 Mars 2022”. Ashtu siç dhe jeni në dijeni, Presidenti i Republikës me dekretin e tij ka përcaktuar datën e zgjedhjeve 6 mars, për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për 6 njësitë e qeverisjes vendore, dhe përkatësisht për Bashkinë Shkodër, Bashkinë Dibër, Bashkia Durrës, Bashkia Vorë, Bashkia Rrogozhinë dhe Bashkia Lushnje. Referuar përcaktimeve të nenit 97, pika 2 të Kodit Zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, zgjedhësi voton me dy fletë votimi. Një për kryetarin e njësisë dhe një për këshillin. Në zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars, duke qenë se votohet vetëm për kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore, zgjedhësi do të votojë vetëm me një fletë votimi. Neni 98 përcakton se fleta e votimit përgatitet nga KQZ-ja dhe jep përcaktimet e karakterit normativ.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.07.02.2022*

Konkretisht fleta e votimit duhet të jetë prej letre me ngjyrë, trashësi, ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojë leximin e votës në pjesën e pasme të saj. Fleta e votimit përmban dhe elemente sigurie, sipas përcaktimeve me akt normativ të KQZ-së. Fleta e votimit përmban gjithashtu dhe elemente teknike në formën e kodeve. Fleta e votimit prodhohet me blloqe pa kundërfletë. Numri i serisë së bllokut të fletëve të votimit shënohet në dokumentin që shoqëron bllokun e ambalazhuar, sipas përcaktimeve të KQZ-së. Këto janë kërkesat e nenit 98 të Kodit Zgjedhor. Referuar edhe eksperiencës së mëparshme, ne ju kemi paraqitur projektvendimin dhe specifikisht në lidhjen 1 të tij janë përcaktuar specifikimet teknike që do ketë fleta e votimit që do të përdoret në zgjedhjet e datës 6 mars. Bashkëlidhur keni relacionin, projektvendimin së bashku me lidhjen 1 të tij.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Kodra! Në fakt miratimi i specifikimeve teknike të fletës së votimit është një vendimmarrje e Komisionit Rregullator pas ndryshimeve të Kodit Zgjedhor në vitin 2020, duke u konsideruar akt normativ sipas nenit 98, pika 1 të Kodit Zgjedhor. Nisur nga kjo do të thoja që ne kemi miratuar edhe më herët në rastin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill, specifikime teknike lidhur me fletën e votimit. Të paktën me sa kam vërejtur janë dimensionet e fletës së votimit ato që kanë ndryshuar në raport me zgjedhjet për Kuvend. Pra, ishte formati A-3 për zgjedhjet për Kuvend dhe këtu është formati A-4. A ka ndryshime të tjera në specifikimet teknike?

**Z. B. Kodra:** Nga sa kemi propozuar nuk ka asnjë ndryshim tjetër. Edhe ky ndryshim dimensionit është bërë për tu referuar praktikës së mëparshme, në të cilat gjithmonë zgjedhjet e pushtetit vendor, fletët e votimit për kryetar të njësisë vendore ka qenë e këtyre dimensioneve, e formatit A-4.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**Znj. I. Nano:** Në rregull, faleminderit! Atëherë fillojmë në parim diskutimin.  
Kolegë, zoti Çakaj?

**Z. M. Çakaj:** Faleminderit zonja Nano! Siç ju e referuat dhe më parë, me vendimin nr. 6, datë 26 shkurt, Komisioni Rregullator ka miratuar specifikimet teknike të fletës së votimit, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021. Përveç dimensioneve të fletës së votimit, gjithashtu referuar dhe nenit 98 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet që fleta e votimit duhet të përmbajë kode të fshehura. Këtu unë vërej që në ndryshim nga specifikimet teknike të vendimit nr. 6, pra nuk kemi një *barcode*, por kemi *QR Code*. Mund të na sqaroni më specifikisht, bëhet fjalë për të njëjtën gjë, apo bëhet fjalë për dy kode të cilat identifikojnë, ose rrisin cilësisë e sigurisë.

**Z. B. Kodra:** Absolutisht është e njëjta gjë. Si *barcode*, si *QR Code*, që njihet rëndom. Për shkak të teknikalitetit të prodhimit kohët e fundit nuk përdoret më *barcode*, përdoret *QR Code*. Informacioni që përmbajnë brenda është i njëjtë. Pra, përmbajnë brenda atë numrin serial që ju kemi shpjeguar, që është i padukshëm në të dy rastet.

**Z. M. Çakaj:** Po, e qartë! Pra, është kod sigurie i materializuar në një formë tjetër? Në formën e *QR Code*!

**Z. B. Kodra:** Në thelb është *barcode* prapë. Po njihet me një emër tjetër, *QR Code*, por është e njëjta gjë.

**Z. M. Çakaj:** Qartë!

**Znj. I. Nano:** Në rregull! Kolegë, zonja Vukaj, po!

Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU



**Znj. H. Vukaj:** Një pyetje për zotin Kodra! Ky duke qenë që është një akt repetitiv, që vjen për procedurë, por dhe në përshtatje të këtyre zgjedhjeve. Meqenëse jemi këtu për të reflektuar edhe ndaj pasigurive, apo mungesës së ndonjë elementi që mund të na ketë shkarë më parë. Për t'i dhënë konsolidimin e duhur aktit dhe për të siguruar opinionin publik, do të doja të pyesja zotin Kodra, ose dikë tjetër që është aktiv si draftues i këtij akti. Çfarë sigurie ka zbërthimi që i keni bërë ju në lidhjen 1, bashkëlidhur draftaktit, specifikimeve të përgjithshme ku thoni “do të përmbajë stemën e Republikës me ngjyra, dimensione, logo KQZ-je, me ngjyra dimensione, *QR Code*, element teknik në formën e kodeve”. Keni bërë një zbërthim, numrin serial me 6 shifra, bashkia 2 shifra, zona e administrimit zgjedhor 2 shifra, numri i qendrës së votimit 5 shifra. Duke qenë që ka pasur aludime apo anateme në këtë prizëm që sapo parashtrua, a çënojnë sigurinë e fletës së votimit dhe lirinë apo leximin e votës, ky ekspozim që është bërë në këtë akt? I cili duhet të mbetet akt normativ dhe nuk duhet të detajohet deri në prizmin e specifikimeve teknike, siç ju keni parashtruar?

**Z. B. Kodra:** Në gjykimin tonë këtu nuk përbëjnë asnjë lloj problemi, pasi edhe vetë kodi në kërkesat e tij parashikon që numri serial duhet të përmbajë edhe numrin e zonës së administrimit edhe numrin e qendrës së votimit. Ajo që kemi shtuar këtu është numri serial dhe bashkia, por që janë krejt normale dhe për më tepër këto nuk çënojnë asnjë siguri, pasi i gjithë ky numër serial, me të gjithë këto elemente të tij është krejtësisht i padukshëm. Ashtu siç e kërkon edhe kodi. Pra, i padukshëm me sy të lirë.

**Znj. H. Vukaj:** A mendoni që duhet të jenë pjesë e këtij akti në nivel normativ kodet e shtuara dhe zbërthimi i kodeve që i keni bërë? Sepse personalisht për

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



mua nuk janë në nivelin e normës, zbërthimi deri në këtë detaj. Për më tepër që ligjvënësi të thotë në paragrafin e dytë, të pikës 1, në nenin 98 “fleta e votimit përmban elemente teknike në formën e kodeve”. Pra, janë të paeksponuar për një akt, i cili bëhet publik. Për siguri të kësaj procedure dhe të fletës së votimit, unë personalisht dhe juridikisht do të preferoja që thjesht të përmendnim, “të përmbajë specifikimet e përgjithshme që në kod (elementet teknike) në formën e kodeve sipas përcaktimeve në Kodin Zgjedhor”. Se si e vendosni, dhe se si negocioni për sigurinë e fletës me operatorin tregtar që do prokurojë fletën, është çështje që duhet të mbetet pjesë e negociatave dhe të mos ketë një ekspozitë kaq publike.

**Znj. I. Nano:** Unë mendoj që me këtë vendim, duke miratuar specifikimet teknike deri në këto detaje, KQZ-ja është gati të prokurojë fletën e votimit. Pra, këto specifikime teknike janë specifikime teknike për procedurën e prokurimit që do të zhvillojë. Që do të thotë, kur të zhvillohet procedura e prokurimit, do të njihen të gjithë operatorët me të gjitha elementet që duhet të përmbajë fleta e votimit. Po zoti Kodra, kishit diçka?

**Z. Y. Merkaj:** Unë mendoj që fletët e votimit të përmbajnë elemente teknike në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit. Këtu nuk lëvizim dot. “Si dhe elemente të tjera identifikuese”, këtu mund të lëvizim ne. “Elemente të tjera identifikuese”. Zonë zgjedhore...

**Znj. H. Vukaj:** Në momentin që thotë “ligjvënësi ka thënë element teknik në formën e kodeve” është e padeshifrueshme.

**Z. Y. Merkaj:** Që identifikojnë...,po pra që nuk lexohen me sy të lirë.

**Znj. H. Vukaj:** Po jo, ne jemi duke e deshifruar këtu. 6 shifra themi numri serial, bashkia 2 shifra..

**Z. Y. Merkaj:** Jo këtu mund ta lëvizim. Zonën zgjedhore dhe qendrën e votimit nuk e lëvizim dot. “Elemente të tjera identifikuese”, mund të flasim pastaj.

**Znj. H. Vukaj:** Jo nuk i lëvizim kurrsesi ato. Por duhet të jenë në formën e kodeve. Pra, të mos ekspozohen, të jenë të padeshifrueshme. Kodet, do të thotë diçka e padeshifruar.

**Z. Y. Merkaj:** Nuk deshifrohet me sy të lirë nga bar kodi.

**Znj. H. Vukaj:** Me sy të lirë jo, por ideja është që do mbetemi në nivelin e një akti normativ apo do të bëjmë zbërthimin e karakterit të një akti formal administrativ?

**Znj. I. Nano:** Po, zoti Kodra!

**Z. B. Kodra:** Ajo çka ne kemi propozuar është sesi do të jetë i ndërtuar ky numër serial, me nga këto elemente. Nuk është se këtu kemi dhënë numrat dhe i bëjmë lehtësisht të dallueshëm. Për shembull, ne themi që bashkia identifikohet me dy numra, sesi do të jenë ato e dinë, janë ato, si të thuash përcaktimi i elementeve të sigurisë të fletëve të votimit, se cilët numra do të jenë konkretë në këtë bashki. Pra, këtu nuk po them që, nuk po ekspozoj numrat, ose po zbuloj numrin serial. Them thjesht që për t’u identifikuar një fletë votimi e një bashkie nga një tjetër, ka një numër që përbëhet nga dy numra. Pra, ka një numër rendor me dy numra 01, 02 e kështu me radhë. Ky është një teknikalitet më tepër.

**Znj. I. Nano:** Që i takon Komisionit Rregullator ta vendosë për shkak se miraton specifikimet teknike të fletës. Po, zoti Çakaj!

**Z. M. Çakaj:** Unë mendoj, përsa kohë në këtë akt duke marrë në konsideratë dhe duke vlerësuar me seriozitet dhe shqetësimin e zonjës Vukaj. Por, përsa kohë në këtë akt, së pari janë identifikuar vetëm numri i shifrave, pra duke ruajtur anonimat. Pra, duke mos zbuluar ato shifra. Nga ana tjetër edhe përcaktimi i administratës se këto do të jenë të padukshme, pra ruajmë elemente të sekretit, kështu që unë besoj se e tejkalojmë atë. Merakun tonë që me të drejtë e ngriti dhe kolegja Vukaj, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Diskutime të tjera në parim, kolegë? Nëse jo, kalojmë në votimin në parim të projektvendimit “Për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar, në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që do të zhvillohen në datën 6 Mars 2022”.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen. Ky vendim ka 3 pika.

Pika e parë. Miratimi i specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Në fakt diskutimi i deritanishëm ka qenë pikërisht sipas lidhjes 1. Propozime për shtesa, ndryshime për pikën 1? Zonja Vukaj!



**Znj. H. Vukaj:** Vërtet ne morëm siguri dhe lindi në formën e pyetjes. Pra diskursi, a garantojmë siguri me këtë *barcode* ose *QR Code* dhe përgjigjja që erdhi nga specialisti, ishte që po, garantohet. Pyetja e dytë ishte, a i kapërcejmë kufijtë e një akti normativ me gjithë këto specifikime? Sekretari i Përgjithshëm pohoi që kemi disa teprira, të cilat tejkalojnë paragrafin 2 të nenit 1. Atëherë në qoftë se do t'i mbeteshim paragrafit 2, të pikës 1, neni 98 "Përmbajtja e fletës së votimit", duhet t'ia linim specifikimeve teknike disa elemente të zërthimit të *QR Code*.

**Znj. I. Nano:** Tani unë nuk e di e kujt do të ishte kompetenca për të miratuar specifikimet të tjera teknike. Në fund të fundit kodi na e ka dhënë ne të drejtën dhe detyrën për të miratuar me akt normativ specifikimet teknike. Pra, në qoftë se ne nuk i miratojmë këto të dyja që ju po thonit, përveç atyre që kodi thotë në mënyrë nominale. Pra, në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit, këto të dyja. Të tjerat janë elemente të tjera identifikuese, thotë kodi. Elemente të tjera identifikuese që nuk lexohen me sy të lirë janë dhe këto dy elemente. Numri serial dhe bashkia me dy shifra. Pra, 6 shifra për numrin serial. Pra, nëse nuk e miratojmë ne, kush i miraton? Kjo është çështja! Zonja Vukaj ka pyetje, po për administratën!

**Znj. H. Vukaj:** Një pyetje zotit Sekretar, specialistit apo ekspertët! Numri serial dhe bashkia, a do të ishin elemente të mjaftueshme në funksion të, "si dhe elemente të tjerë identifikuese", apo do na dalin elemente të tjera, të cilat do të ridimensiononin Kodin në tërësi?

**Z. Y. Merikaj:** Në praktikën e deritanishme të KQZ-së, që ka propozuar dhe ka miratuar fletën e votimit specifikimet. Kemi vendosur 2 shifra për zonën zgjedhore, 5 shifra për qendrën e votimit dhe numrin serial të fletës së votimit.

*Zbardhi materialin audio  
Merița DULAKU*



Këtë kemi përcaktuar ne deri tani. Ju mund të caktoni nga zona zgjedhore, jo dy shifrat, mund të caktoni dy numrat, dy shkronja. Për Vorën mund të vësh VO, VE, VRV. Ne këtu kemi propozuar duke iu përmbajtur më tepër dhe eksperiencës së mëparshme.

**Znj. H. Vukaj:** Të gjitha këto pyetje shtrohen për siguri të publikut. Ne kemi miratuar më përpara një draft të ngjashëm, por meqenëse ka pasur aludime ndaj u shtruan të gjitha këto. Le të marrë përgjigje publiku nga ju që e keni draftuar dhe e njihni situatën nga fillimi i leximit të këtij akti deri në prokurimin fundor, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Pra dhe njëherë bashkohem me shqetësimin e koleges Vukaj. Me këto specifikime, me këto elemente sigurie, a është fleta e votimit e sigurt? A duhet të shtojmë elemente të tjera sigurie? Sepse që të pakësojmë, mendoj që s'ka kuptim! A janë të mjaftueshëm këto elemente? Nisur nga përvojat e zgjedhjeve të kaluara nga verifikimi paszgjedhor që është bërë, nisur dhe nga përvoja e zgjedhjeve në vendet e tjera. A janë të mjaftueshme këto elemente sigurie?

**Z. B. Kodra:** Në projektaktin e propozuar në Lidhjen 1, deri tani diskutuam vetëm për një element të sigurisë që është numri serial, ose *QR Code*. Në vetvete nga eksperiencia e mëparshme, fleta e votimit përmban disa elemente sigurie. Pra, nuk është vetëm ky numër serial. Fleta, lloji i letrës në vetvete është një element. Përveç atyre gjatë printimit, të gjitha kompanitë që kanë prodhuar, përcaktojnë ato elemente sigurie dhe këto të padukshme me sy të lirë, të cilat më pas i depozitojnë pranë një noteri këto elemente sigurie. Ky zarf në momentin që fletët e votimit vijnë pranë KQZ-së, depozitohet në zyrën e protokollit dhe hapet nëse do të lindë e nevojshme për ndonjë verifikim

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit. Ftoj kolegët të shprehin dhe njëherë dakordësinë e tyre lidhur me aktin.

Kolegë, kush është dakord?

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Duke qenë që nuk kemi një akt tjetër apo një çështje tjetër për shqyrtim në rendin e ditës, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

**Vendimi nr. 14**

Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU

